



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:078734
Datë: 17.10.2024
Numri i dokumentit: 06312787

C.nr.1238/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË–Departamenti Përgjithshëm, me gjyqtaren Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.L., nga fshati V., Komuna e P., të cilin e përfaqëson Bajram A.Lajqi, avokat në Pejë, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Prishtinë, të cilën e përfaqëson F.Xh., avokat shtetëror, Prishtinë, baza juridike: kompensim i shujtave ditore, shpërblimit jubilar dhe pagës shpërblyese të përformancës, vlera e kontestit: 5.980,05€, në shqyrtim kryesor të mbajtur, me dt.01.10.2024, në prezencën e të autorizuarit të paditësit, e në mungesë të autorizuarit të paditurës, me dt.14.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësit A.L., nga fshati V., Komuna e P., , SI E BAZUAR ashtu që:

I. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, që në emër të pagave shpërblyese për përformancë plotësisht të kënaqshëm për vitet: 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, t’ia paguajë paditësit shumën e përgjithshme prej 3,271.05€, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë dt.23.04.2021, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit A.L., nga fshati V., Komuna e P., përtej shumës së gjykuar, me të cilën ka kërkuar që të: „DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, që të paguajë shumën prej 2.709€, në emër të kompenzimit për shujta ditore për 903 ditë të punës, të pa paguara nga dt.15.11.2018 deri me dt.31.12.2022.”, SI E PA BAZUAR.

III. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme–Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, që paditësit t’ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 689€.

A r s y e t i m

Paditësi A., përmes të autorizuarit të tij, me dt.23.04.2021, ka paraqitur padi kundër të paditurës, ndërsa me dt.18.09.2024, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë pas ekspertizës financiare.

Gjatë shqyrtimeve të mbajtura, i autorizuari i paditësit, ka parashtruar se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga dt.20.11.2000, dhe që nga ajo kohë,

paditësi ka vazhduar punën pa ndërprerë në Policinë e Kosovës, dhe për punën e tij merr pagën mujore në shuma të ndryshme, duke filluar nga viti i parë konkretisht në vitin 2001, ka pasur pagë mujore prej 613.05€.

Paditësi gjatë viteve: 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 në Policinë e Kosovës, ka punuar në vazhdimësi dhe ka pas vlerësim të kënaqshëm, i cili është vlerësuar me notën 4 dhe 5, dhe gjithashtu nga dt.15.11.2018 e gjerë me dt.31.12.2022, ka gjithsej 903 ditë pune.

Ka cekur se me nenin 29 par.1, 2 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, mbi marrëdhëniet e punës në Policinë e Kosovës, pjesëtarëve të Policisë së Kosovës i është garantuar pagesa shtesë në 1. shujtë ditore, 2. personelit të policisë, të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm, dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, andaj meqenëse se paditësi ka vlerësim të plotësisht të këndshme të performancës, 20 vite përvoja pune në Policinë e Kosovës, dhe ka realizuar 957 ditë pune për të cilat kërkesa është bërë e arritshme siç është specifikuar me lartë, dhe e paditura nuk e ka përmbushur pagesën e pagës shpërblyese, dhe shujtave të garantuara me nenin 29 të udhëzimit administrativ të lartcekur, i autorizuar i paditësit i ka propozuar gjykatës në kuptim të nenit 49 të LPK-së, që pas administrimit të provave të aprovojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

I autorizuari gjendjen faktike e ka përshkruar si në vijim: se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Ministrinë e Punëve të Brendshme respektivisht në Policinë e Kosovës, që nga dt.20.11.2000 e tutje. Paditësi ka vazhduar punën pa ndërprerë në Policinë e Kosovës dhe për punën e tij merr pagën mujore në shuma të ndryshme, duke filluar nga viti i parë konkretisht në vitin 2001 ka pasur rrogë mujore prej 613.05€. Me dt.14.11.2018, Policia e Kosovës ka nxjerr Udhëzimin Administrativ me nr.02/2018, me anë të të cilit policëve që kanë performancë të mirë të obligohet t'iu paguaj pagën e trembëdhjetë që është ekuivalente me pagën mujore për paditësin për çdo vitë kalendarikë dhe shujtat ditore, për ditët që kanë punuar që nga nxjerrja e këtij udhëzimi e deri më sot, por Policia e Kosovës këto paga e as shujtat ditore, nuk i'a ka paguar asnjëherë paditësit, edhe pse paditësi ka treguar performancën e kërkuar. Paditësi gjatë viteve 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 në Policinë e Kosovës ka punuar në vazhdimësi.

I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së saj, dhe parashtresave për precizimin e kërkesëpadisë, duke konsideruar se nga provat e administruara, është argumentuar kërkesëpadia, ndërsa në kuptim të nenit 29 par.1, 2 dhe 5, të UA.nr.02/2018, dhe nenit 30 par1 dhe 2 të UA.nr.01/2021, të Policisë së Kosovës, është vërtetuar edhe baza juridike e kërkesëpadisë, andaj, Gjykatës i ka propozuar që të njëjtën ta aprovoj si të bazuar dhe të obligoj të paditurën edhe në pagesën e shpenzimeve gjyqësore dhe atë: për përpilim të padisë shumë prej 104€, për tri seanca të mbajtura nga 135€ shumë prej 405€, si dhe shumë prej 150€, në emër të shpërblimit për ekspert, si dhe taksën gjyqësore në shumë prej 30€ e në total shumë prej 689€.

E paditura me përgjigje në padi, e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar përveç tjerash se paditësi nuk i ka shtjer mjetet e rregullta të ankimit, bazuar në dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit Nr.03/L-212. Se kërkesëpadia është në kundërshtim me nenit 87, që ka të bëjë me parashkrimin e paraqitjes së kërkesës...dhe njëkohësisht ka theksuar se UA/Nr.02/2018, mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, në të cilën është mbështet padia e paditësit, është shfuqizuar nga UA.Nr.01/2021, që ka hyrë në fuqi me dt.29.09.2021, e që rrjedhimisht nuk mund të aplikohet për periudhën 2022.

Ka cekur se Ministria e Financave, në përputhje me nenin 19 të Ligjit Nr.07/L-041 për Ndarjet Buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2021, përkatësisht Ligjin Nr.05/L-125, nenin 20 par.4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj as një obligim financiar nuk është i obligueshëm për deri sa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që mungesë të mjeteve financiare nuk ka mundësi që të realizohet, ndërsa me nenit 45 par.2 të Ligjit

të pagave 2023 shfuqizohet çdo dispozitë e ligjit apo akt nënligjor, që rregullon çështjet e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve...

Lidhur me kërkesën për kompensimin e shujtës etj. ka cekur se duke marr parasysh se kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale, të paditurës dhe se asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim, andaj, e konsiderojnë se nuk është obligim i të paditurës, sepse deri me tani nuk ka pasur mundësi financiare, për këtë ka propozuar që të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e saj si e bazuar.

E paditura gjegjësisht i autorizuari i saj, nuk ka prezantuar në seancat e shqyrtimit gjyqësor të dt.01.10.2024, edhe përkundër faktit se i njëjti ka qenë i ftuar nga ana e gjykatës në mënyrë të rregullt, me çka gjykata konform nenit 423 par.4 të LPK-së, seancën e ka mbajtur në mungesë të tij.

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: vërtetimin punësimit për paditësit i dt.14.04.2021, formulari i vlerësimit të përfundimit për vitet 2018, 2019 dhe 2020; evidencenca e vijueshmërisë në punë e paditësit për vitet e cekura; parashtrësia për rregullimin e padisë për evidencën e vijueshmërisë dhe përfundimit për vitet shtesë për vitet 2021 dhe 2022; ekspertiza e ekspertit financiar A.H. e dt.10.09.2024 dhe deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse dhe të gjitha shkresave tjera, që gjenden në lëndë.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në lidhshmëri me njëra-tjetrën, çmuarjes me kujdes e ndërgjegje të secilës provë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që me provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

-nga vërtetimi punësimi për paditësin të dt.14.04.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka themeluar marrëdhënie punë me të paditurën Policinë e Kosovës dhe atë në pozitën me gradë: Hetues i vendit të ngjarjes,

-nga formulari i vlerësimit të përfundimit për vitet: 2018, 2019 dhe 2020, si dhe nga evidencenca e vijueshmërisë në punë e paditësit për vitet e cekura; parashtrësia për rregullimin e padisë për evidencën e vijueshmërisë dhe përfundimit për vitet shtesë për vitet 2021 dhe 2022, vërtetohet fakti se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës, që nga dt.20.11.2000, me pagë momentale prej 613.05€ për një muaj kalendarik,

-nga provat e cekura më lartë, vërtetohet pa dyshim fakti: se paditësi A.L., është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me nivel të vlerësimit me notën (4)katër, që nënkupton plotësisht i kënaqshëm, fakte të cilat ishin të pa kontestuara edhe nga pala e paditura.

Gjatë shqyrtimit kryesorë e paditura nuk ka prezantuar ndonjë provë që argumenton se paditësit i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore në marrëdhënien e tij të punës në Policinë e Kosovës.

Nga kalendari i vijueshmërisë në punë, për paditësin A., për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, vërtetohet fakti se paditësi ka qenë korrekt në vijueshmërinë në punë.

Midis palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, pasi që kjo rrethanë konstatohet dhe nga vërtetimi personal i lëshuar nga Major J.J.–Shef i Sektorit Rajonal për Resurse, DRP-Pejë, e sipas së cilës paditësi është i sistemuar në vendin e punës dhe atë nga dt.20.11.2000, e tutje me të cilin vërtetohet se i njëjti ka më shumë se 20 vite përvojë të punës.

Nuk është kontestuese edhe vlerësimi nga institucioni për paditësin, sipas të cilave paditësi është vlerësuar me vlerësim të lartë, dhe se gjatë periudhës që është objekti i kërkesës

(vitet 2021-2022) nuk ka pasur ndonjë vërejtje ose ndonjë masë disiplinore, kjo u vërtetua nga provat e administruara.

Kontestuese në mes palëve ndërgjyqësve ishte sa a i takon apo jo paditësit shpërblim për performancë plotësisht të kënaqshme, për çdo vit kalendarik, respektivisht për vitet: 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, dhe kompensimi për shujtat ditore brenda kësaj periudhe kohore.

Baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit rrjedhë nga Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ku në kapitullin VI që i referohet pagave dhe sistemimit të personelit të policisë, neni 29 par. 2 i këtij udhëzimi përcakton se: *„Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda viti përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*. Që në rastin konkret paditësi në vlerësimet e përformancës së bërë gjatë periudhës kohore 2018-2022 u vërtetua fakti se të njëjtit nuk i është shqiptuar asnjë vërejtje apo masë disiplinore.

Në këndvështrimin e gjykatës, kjo dispozitë është imperative dhe nuk lejon hapësirë për interpretim, andaj duhet zbatuar çdo herë në fund të vitit për secilin hetues policor, ndaj të cilit nuk është shqiptuar masë disiplinore dhe të cilët kanë pasur vlerësim të kënaqshëm.

Nga provat e administruara, paditësi ka përmbushur të dyja këto kushte në mënyrë komulative, pra ai është vlerësuar kënaqshëm, dhe ndaj tij nuk është shqiptuar ndonjë masë disiplinore për periudhën 2018–2022.

Bazuar në nenin 329, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), që përcakton se *„Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, gjykata i mori të besueshme provat e bashkëngjitura nga paditësi, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga organi shtetëror, respektivisht nga vetë e paditura.

Gjykata, përfundimisht nga kjo gjendje faktike, vërtetojë se themelësia pjesërisht e kërkesëpadisë, bazën ligjore e ka në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës, që përcakton decidivisht se *„I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*, nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se *„Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*; nenin 55, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 se *„Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, që në nenin 5.par.2 përcakton se *„Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*; pika 2 e këtij se *“Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”*; si dhe nenin 29, paragrafi 2 ku përcaktohet se *„Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*, një të drejtë e parasheh edhe neni 30 i Udhëzimit Administrativ me nr.01/2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj t’ia paguajë një pagë shtesë, ekuivalente me pagën mujore, për çdo fund vit, pasi janë plotësuar edhe kushtet për një të drejtë të tillë, siç parashihet në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i dt.14.11.2018, më saktësisht vlerësimi i përformancës

për vitet: 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, ka qenë nivelin (4)-plotësisht i kënaqshëm, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën totale për paditësin, që në emër të pagave shpërblyese, për performancë plotësisht të kënaqshëm për vitet: 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022, e paditura t'ia paguajë paditësit shumën e prej 3,271.05€.

Me qëllim të vërtetimit të saktë të lartësisë së kërkesëpadisë gjykata ka bërë nxjerrjen e provës me anë të ekspertizës nga lëmia financiare, dhe ka marr mendimin e ekspertit financiar ecc. dipl.A.H.(të dorëzuar edhe me shkrim në gjykatë me dt.10.09.2024), në të cilën ka dhënë sqarime dhe ka bërë llogaritjen për periudhën kontestuese të cilën e ka bërë mbi bazën e pagave të raportuara në TRUST ku ka nxjerr mesataren mujore, të pagave vjetore të realizuara, dhe nga përlllogaritja ka rezultuar për kompensimin e pagës së 13-të për pesë(5) vite(2018, 2019, 2020, 2021-2022) në shumë prej 3.271,05€, ndërsa nga përlllogaritja e kryer në emër të shujtës ditore për periudhën 2018 deri 2022, për 903 ditë pune nga 3€ në dite, ka rezultuar shuma për kompensim prej 2.709,00€, e në shumën totale prej 5.980,05€.

Gjykata i ka vlerësuar edhe prapësimet e tjera të palës së paditur, e posaçërisht pretendimin se dispozita e nenit 29, të Udhëzimit Administrativ, nr.02/2018 për marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore-financiare, nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të, mirëpo një pretendim i tillë për gjykatën është i pathemeltë sepse Udhëzimi Administrativ i lartcekur është akt juridik i veçantë që zyrtarëve të Policisë së Kosovës ua njeh këtë të drejtë, pra ai është (*lex specialis*) me të cilin rregullohet çështja e pagave dhe shpërblimeve në marrëdhënie të punës dhe si i tillë duhet zbatuar, çka do të thotë se nuk ka vend për interpretim ndryshe, por duhet të zbatohet në secilin rast kur përmbushen dy kushtet e cekura më lartë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që ka gjetur se paditësit nuk i takon kompensimi i shujtave ditore, duke u bazuar në nenin 29, paragrafi 1 të UA 02/18, që përcakton se „Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”, e në lidhje me nenin 47, paragrafi 4 të Ligjit për Policinë që përcakton se „Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore”. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se përcaktimi në aktet ligjore dhe nënligjore për shujta ditore duhet të jetë shprehimisht i përcaktuar që të mund të vijë në shprehje zbatimi i kësaj dispozite, ndërsa në rastin konkret meqë nuk ekziston ky përcaktim në legjislacionin në fuqi, e as në aktet nënligjore, kjo dispozitë mbetet e karakterit deklarativ, por nuk mund të ketë fuqi detyruese për palët nënshkruese.

Lidhur me pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, se te gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës, parashkruhen brenda afatit prej tri(3) vitesh, nga dita e paraqitjes se kërkesës, andaj në rastin konkrete kemi të bëjmë me kërkesë të parashkruar, gjykata një pretendim të tillë e refuzohen si të pa bazuar duke u nisur nga fakti se kërkesa e paditësit ka të bëjë me kompensimin e pagave të 13-ta për vitet: 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 dhe padia në gjykatë është parashtruar në vitin 2021, andaj në rastin konkretë nuk kemi të bëjmë me parashkrim sipas dispozitave të LMD-së, pasi që padia është paraqit në gjykatë brenda afatit ligjor 3 vjeçare, çka do të thotë se pala paditëse në rastin konkret nuk e ka humbur të drejtën që të kërkojë përmbushjen e detyrimit në procedurë gjyqësore, sepse kërkesa e tij është e afatshme.

Gjykata, për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077 të datës 19.06.2012, ku shprehimisht është përcaktuar se „*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore bazuar nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së, dhe lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara ka të bëjë: për përpilim të padisë shumë prej 104€, për tri seanca të mbajtura nga 135€ shumë prej 405€, shumë prej 150€, në emër të shpërblimit për ekspert, si dhe taksën gjyqësore në shumë prej 30€, e në total shumë prej 689€.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE PEJË, C.nr.1238/21, me dt.14.10.2024.

Gj y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes të kësaj gjykate.